



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 189 / 11 Prot.

Tiranë, më 11 . 06 .2020

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr 5 datë 11 . 06 .2020

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM nr.469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”,

VENDOSI:

1. Miratimi i botimit dygjuhësh të 10 tregimeve nga vëllimi "**Tregime të moçme shqiptare**" të Mitrush Kutelit në shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, sipas projekti bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën**

**PIRO MISHA**

Anëtarë

Znj. Ada Ilia

Znj. Mira Hoxha

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Floresha Dado





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN



Titulli i projektit:  
Botimi dygjuhësh i dhjetë tregimeve  
të përzgjedhura nga  
"Tregime të moçme shqiptare"

*[Handwritten signatures and initials]*



## **Titulli i projektit:**

Botimi dygjuhësh i dhjetë tregimeve  
të përzgjedhura nga **“Tregime të moçme shqiptare”**,  
me autor Mitrush Kutelin,  
në shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht,  
shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht

1. Përmbajtja
2. Qëllimet dhe objektivat
3. Metodologjia
4. Aktivitetet kryesore
5. Rezultatet kryesore
6. Përfituesit
7. Financimi
8. Zona e zbatimit
9. Grupi i punës
10. Emrat e përkthyesve për diskutim
11. Ilustrimet Gazmend Leka



Four handwritten signatures in blue ink, arranged horizontally. From left to right: a stylized signature, a signature that appears to be 'F. Leka', a signature that appears to be 'A. ...', and a signature that appears to be 'A. ...'.

## 1. Përmbajtja

"Tregime të moçme shqiptare" është një ndër veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe që mund të lexohet në çdo moshë.

Në libër përfshihen balada dhe rapsodi popullore të ritreguara dhe të përshtatura për moshën 11-14 vjeç. Vëllimi shërben për njohjen më të mirë të gjuhës shqipe, eposit, folklorit dhe në tërësi të kulturës shqiptare.

"Tregime të moçme shqiptare" vlerësohet si për pasurinë e fjalorit, ashtu dhe për estetikën e lëvrimin të gjuhës shqipe.

Këto tregime dhe përralla do të shërbejnë për zgjerimin e njohurive, marrjen e informacionit dhe kultivimin e dijeve të nxënësve në Diasporë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën amtare.

Në vazhdim të projektit të botimeve dygjuhëshe, QBD-ja synon botimin e 10 (dhjetë) tregimeve të përzgjedhura nga vëllimi, që do të përkthehen në 5 (pesë) gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.

Pas një pune të kujdesshme dhe konsultimi, redaksia përzgjedhi 10 tregimet e mëposhtme:

1. *Rozafati;*
2. *E bija e Hënës dhe e Diellit;*
3. *Besa e Kostandinit;*
4. *Gjergj Elez Alia;*
5. *Ymer Agë Ulqini;*
6. *Muji dhe Zanat;*
7. *Omeri i Ri;*
8. *Dasma e Hysen Kraposhnikut;*
9. *Halili pas vdekjes;*
10. *Skënderbeu e Ballabani.*





## 2. Qëllimet dhe objektivat

Synimi ynë është botimi dygjuhësh i 10 tregimeve nga “Tregime të moçme shqiptare”. Botimi do të shërbejë edhe si tekst ndihmës për shkollat në Diasporë, me qëllim zgjerimin e njohurive të tyre mbi gjuhën shqipe.

Ky libër është i vlefshëm për fëmijët dhe të rriturit në Diasporë, me njohuri të mjaftueshme në gjuhën shqipe, dhe u mundëson atyre një thellim të njohurive për gjuhën dhe për kulturën shqiptare.

Vepra e njeh brezin e ri të Diasporës edhe me një autor tjetër të rëndësishëm të letërsisë shqipe, si dhe me një gjuhë të pasur, të kultivuar mjeshtërisht nga Mitrush Kuteli.

Kultivon ndjenjën e krenarisë për identitetin kombëtar shqiptar në Diasporë, duke i njohur ata me pasurinë e tregimeve të moçme shqiptare, si dhe me madhësinë e trashëgimisë tonë popullore.

## 3. Metodologjia

Për realizimin e këtij projektpropozimi, si hap i parë do të na duhet blerja e të drejtave të botimit për 10 (dhjetë) tregime nga “Tregime të moçme shqiptare”, si dhe blerja e të drejtave për ilustrimet e bëra po në këtë libër nga ilustruesi Gazmend Leka, i cili për ciklin e vizatimeve është vlerësuar në vitin 1986 me çmimin e madh kombëtar “Odise Paskali”, si vepra më e mirë në artet figurative.

Së dyti, duhen zgjedhur përkthyesit, të cilët do të realizojnë përkthimin e 10 (dhjetë) tregimeve nga gjuha shqipe në gjuhët përkatëse që mendojmë t’i përkthejmë.

Në përfundim, nga QBD-ja do të realizohet botimi dygjuhësh i librit, përkatësisht në shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht dhe në shqip-frëngjisht (dizajn, faqosje etj.).



## Rezultatet kryesore

Sjellja e rrëfenjave magjepsëse në dy gjuhë do të lehtësojë të fëmijët e Diasporës të kuptuarin më mirë të fjalëve dhe shprehjeve të shqipes, si dhe në këtë mënyrë do t'i bëjë ata të jenë më të interesuar për gjuhën shqipe.


Përmirësimi i njohurive në gjuhën shqipe.

Zotërimi dhe përdorimi i dy gjuhëve në të njëjtën kohë.

Shtimi i dashurisë për librat, rrëfenjat e moçme, leximin te brezat e rinj.

Ruajtja e gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, si shprehje e kulturës, por edhe e atdhedashurisë.

Shtimi i fjalorit dhe i shprehjeve në gjuhën shqipe.

The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: the first signature is 'Dg', the second is 'Eder', and the third is 'Asis'.



## PËRFITUESIT

Fëmijë, të rritur dhe pjesëtarë të komunitetit shqiptar të Diasporës.

## FINANCIMI

Buxheti i shtetit

## ZONA E ZBATIMIT

Në Shqipëri dhe në Diasporë

## GRUPI I PUNËS

Përkthyes të pesë gjuhëve të huaja:  
anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.

## EMRAT E PËRKTHYESVE PËR DISKUTIM:

Përkthyes të pesë gjuhëve të huaja: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.

### Emrat e përkthyesve për diskutim:

**Anglisht:** Ani Gjika, Ardian Vehbiu;  
**Italisht:** Valentina Notaro, Eugenio Scalabrino,  
Caterina Zuccaro, Giovanna Nanci;  
**Greqisht:** Eleana Zhako, Maklena Nika;  
**Gjermanisht:** Andrea Grill, Lindita Arapi;  
**Frëngjisht:** Évelyne Noygues, Edmond Tupja.

**Ilustrimet:** Gazmend Leka

Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes.